

AKTI I THEMELIMIT
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“TERRA CONSTRUCTION” sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 15/09/2023 (dymijë e njëzetë e tre), midis:

- 1- **Z. Fatmir Parllaku** shtetas shqiptar, i biri i Muharrem, lindur me 22/06/1959 në Kukës, banues në Tiranë, nr. personal F90622032S madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zoteron 40% te aksioneve.
- 2- **Z. Sokol Parllaku** shtetas shqiptar, i biri i Fatmir, lindur me 28/07/1991 në Kukës, banues në Tiranë, nr. personal J10728064P madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zoteron 60% te aksioneve.

Në vijim referuar së bashku si **“Ortakët”**.

Palët e sipërcituara përpilojnë këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, me ligjin 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ligjin 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me atë të ligjit Doganor, Fiskal e Tatimor, dhe Autoritetit përkatës sipas objektivit të shoqërisë, krijon Shoqërinë Tregtare të Kufizuar, **“TERRA CONSTRUCTION sh. p. k.**

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria “TERRA CONSTRUCTION” sh.p.k është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë referuar si **“Shoqëria”**).


Neni 2
Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “TERRA CONSTRUCTION” sh.p.k. është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortakët të cilët secili në veçanti gëzojnë kuotat e tyre në shoqëri, në përpjestim me kontributin e dhënë në kapital. Kontributi i Ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortakët e shoqërisë mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur i kanë shlyer të gjitha kontributet e tyre.

Neni 3
Selia

Shoqëria do ta ketë selinë në Tiranë, Shqipëri, me adresë: : Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajes, objekti i pasurisë nr.6/338, nr hipoteke 831.



Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e Ortakëve.

Neni 4


Objekti i Veprimtarisë

Ne fushen e projektimit dhe te ndertimit: kat. 1/epplanvendosje e objekteve te vecanta, kat. 2/a, projekttime dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b- projekttime dhe ndertime civile industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme per to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekorimi etj.) e-projektim interieri, mobile, pajisjes, dizajn industrial. Ne fushen e ndertimit per zbatim: punime dhu, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarmeje dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante elektrike, telefoni, citofoni, dhe mirembajtja e tyre, ndertim rruge, kat. V, VI ndertime rruge kat. III, II, I, ndertim fusha aviacioni, veshje asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrесе) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime ujesjellese dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji. Pre betonarmeje dhe metalike, punime 2 karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinjerike dhe hidrogjeologjike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, nivelime topografike, punime topogjeodezike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash. Nivelime topografike, punime topogjeodezike, punime siperfaqe te gjelberia parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore etj.) instalimi i impianteve te ngrohjes dhe ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nenpresion, restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike, ndertime gazsjellese, naftesjellese, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje te sistemimit hidraulik9imentime, kanale dhe impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metali, instalimet dhe impianteve nenpresion, instalimet per nenstacionet, kabinat e transformatoreve. Prodhim, import —export beton, beton armeje dhe cdo nenproduktit te tij, interte etj. Organizimi i transportit te udhetareve dhe te mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokesor dhe detar, celja e zyrave te agjencive turistike dhe te shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit mete gjitha llojet e mjeteve, organizimin e sherbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale per gjuhe te huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelari. Ne fushen e tregtise import — eksporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industriale, ushqimore, bujqesor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, rere, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve te perpunuara dhe te paperpunuara , e bimeve medicinave, te lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Ne fusha te tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave te servilit, parkim automjetesh, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistik, moteleve si dhe agjencive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te mndshme dhe te patundshem, agjencive per shitblerje, agjenci komisioneve, agjenci transporti, transport te udhetareve dhe te mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashte tij. Vleresim i ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor, grumbullim, transportim, ruajtje, magazinim, transferim te mbetjeve jo te rezikshme urbane, ujrave te zeza, llumrave, mbetjet nga prishjet dhe ndertimet.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njeqind mije) ALL, i ndarë në 2 kuota
Ortakët zotërojnë kuotat e mëposhtme të kapitalit të Shoqërisë:

- Ortaku themelues z.Sokol Parllaku, zotëron një kuotë në vlerën 60,000 (Gjashtedhete mije) ALL e cila përbën 60 % të kapitalit
- Ortaku themelues z.Fatmir Parllaku, zotëron një kuotë në vlerën 40,000 (Dyzet mije) ALL e cila përbën 40 % të kapitalit

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Organet Vendimmarrëse të shoqërisë janë:



- 1- Asambleja e Përgjithshme;
- 2- Administratori.

Shoqëria ka të drejtë që në të ardhmen të shtojë organet e saj, siç mund të jetë Këshilli Administrativ.

Neni 9
Asambleja e Përgjithshme

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme janë: z.Fatmir Parllaku dhe z.Sokol Parllaku.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10 **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është z **Z. Sokol Parllaku** shtetas shqiptar, i biri i Fatmir, lindur me 28/07/1991 në Kukës, banues në Tiranë, nr. personal J10728064P i emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur:
-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo te huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shakllëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Shpërndarja ose Prishja e Shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14
Dispozitat Përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm u miratua në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të **shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "TERRA CONSTRUCTION"**, dhe nënshkruhet nga të gjithë Ortakët themelues në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKËT

Sokol Parllaku



Fatmir Parllaku

